



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I AVOKATIT TË POPULLIT

*për vizitat në stacionet policore*

Për: **Z. Ekrem Mustafa, Ministër**  
**Ministria e Punëve të Brendshme**

**Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm**  
**Policia e Kosovës**

Prishtinë, më 26 nëntor 2018

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar stacionet policore.

### **Datat e vizitave dhe përbërja e grupit monitorues**

1. Stacionet policore të poshtëpërmendura janë vizituar nga MKPT-ja në datat si në vijim:
  - **Stacioni Policor në Shtime, më 30 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Ferizaj, më 30 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Graçanicë, më 30 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Gjilan, më 31 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Ranillug, më 31 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Kaçanik, më 30 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Shtërpçë, më 30 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Viti, më 30 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Kamenicë, më 31 tetor 2018**
  - **Stacioni Policor në Novobërdë, më 31 tetor 2018**
2. Grupi monitorues përbëhet nga udhëheqësja e MKPT-së, dy këshilltarë ligjorë për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjeke-këshilltare, një këshilltar-punëtor social, dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

### **Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës**

3. Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi pa prezencë të zyrtarëve policorë i personave të arrestuar.

### **Garancitë kundër keqtrajtimit**

4. Sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, personat e dyshuar për kryerje të veprës penale mund të mbahen nga policia deri në 48 orë para se të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Policia mund të mbajë dhe të mbledhë informata nga personat, që gjenden në vendin ku është kryer vepra penale dhe të cilët mund të sigurojnë informata relevante (periudha maksimale kohore është gjashtë orë)<sup>1</sup>.
5. Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person

<sup>1</sup> Nenet 162, 163, 164 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

- tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.
6. Sa i përket njoftimit për arrestim, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë të njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arrestimin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.
  7. Sipas Ligjit për Policinë<sup>2</sup>, e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “*ndalim të përkohshëm*”, me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.
  8. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejme “KPT”), në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia: E drejta për t’u njoftuar me të drejtat e tij; e drejta për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin e tij (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën e shtetit nga vjen nëse është shtetas i huaj); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t’u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).<sup>3</sup>
  9. Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përshkruhet në kuadër të sistemi ligjor.
  10. Lidhur me të drejtën themelore të të arrestuarit për të njoftuar personin e tretë (familjarin, mikun... etj.) për faktin e arrestimit, MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se në dosjen administrative të të arrestuarit regjistrohet fakti që i arrestuari është njoftuar me këtë të drejtë ose atë e ka realizuar, por nuk regjistrohet koha kur kjo ka ndodhur. Prandaj, MKPT-ja gjatë vizitës u ka rekomanduar udhëheqësve të stacioneve policore që ta regjistrojnë edhe kohën kur i arrestuari e ka realizuar të drejtën për të njoftuar personin e tretë për faktin e arrestit.
  11. Po ashtu, këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me Ligjin për Policinë.<sup>4</sup>
  12. MKPT-ja gjatë vizitës në stacionet policore në Shtime, Ferizaj, Graçanicë, Ranillug, Kaçanik, Shtërpçë, Novobërdë dhe Kamenicë nuk ka hasur në persona të arrestuar. MKPT-ja ka hasur në persona të arrestuar në stacionin policor në Gjiilan dhe në Viti, të cilët i ka intervistuar dhe nuk ka pranuar ankesa lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar del se Policia e Kosovës i ka respektuar këto të drejta. Gjatë vizitave, MKPT-ja ka vërejtur se në secilën qeli ndodheshin informata të shkruara

<sup>2</sup> Ligji për Policinë, neni 20.

<sup>3</sup> Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f> (02.11.2015).

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës,



lidhur me të drejtat e personave të arrestuar në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht). Gjatë vizitave, MKPT-ja nuk ka hasur në të mitur të arrestuar.

13. Gjatë vizitave, MKPT-ja është njoftuar nga zyrtarët policorë se gjatë intervistimit të personave të arrestuar nuk praktikohet audio-video incizimi i intervistave. MKPT-ja vëren se Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), lidhur me këtë çështje konsideron se:

*“Regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishëm shtesë kundër keqtrajtimit të të arrestuarve. KPT ka kënaqësinë të vërejtë se vënia në përdorim e sistemeve të tilla po shqyrtohet nga një numër i vendeve. Një sistem i tillë mund të sigurojë një proces të intervistimit të kompletuar dhe autentik dhe në këtë mënyrë lehtëson shumë hetimin e çdo pohimi për keqtrajtim. Kjo është në interes të të dy palëve, respektivisht të personave të cilët janë keqtrajtuar nga policia dhe në interes të zyrtarëve policorë të cilët përballen me pohime të pabazuara se janë përfshirë në keqtrajtim fizik dhe presion psikologjik. Po ashtu, regjistrimi elektronik e zvogëlon mundësinë e të pandehurve që më vonë rrejshëm të mohojnë se ata kanë bërë pohime të caktuara”.*<sup>5</sup>

14. Në raportin për vizitën për Irlandë në vitin 2006, KPT-ja thekson:

*“Të gjeturat gjatë vizitës në vitin 2006, sugjerojnë se audio-video incizimet në dhomat e intervistimit në stacionet e Garda, mund të kenë qenë faktorë domethënës që ka kontribuar në zvogëlimin e pohimeve për keqtrajtim fizik të personave të arrestuar”.*

15. MKPT-ja e Avokatit të Popullit, si edhe në raportin me rekomandime drejtuar Policisë së Kosovës më 25 janar 2018, inkurajon Policinë e Kosovës që të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të një sistemi të tillë të audio dhe video incizimeve në pajtim me konstatimet e KPT-së dhe për këtë të njoftojë Avokatin e Popullit.

#### **Regjistrat (dosjet e të arrestuarve)**

16. MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha stacionet policore që i kanë vizituar posedojnë dokumentin standard (dosjen e të arrestuarit), në të cilin regjistrohen të gjitha të dhënat lidhur me të arrestuarin, në pajtim me nenin 172 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
17. Përveç kësaj, MKPT-ja ka vërejtur se në secilin stacion policor kishte dokumente konkrete shtesë, në të cilat autoritetet policore kishin evidentuar me përpikëri çdo ngjarje lidhur me personin e arrestuar. Po ashtu, MKPT-ja ka hasur edhe në raste kur zyrtarët policorë, përgjegjës për qelitë e mbajtjes, me iniciativën e tyre kanë përpiluar program kompjuterik për mbajtjen e të dhënave për personat e arrestuar. Kjo praktikë nuk është unike në nivel të vendit.

<sup>5</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, ekstrakt nga raporti i 12 i përgjithshëm, paragrafi 36. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (02.11.2018).

## Keqtrajtimi fizik

18. MKPT-ja gjatë vizitës në stacionin policor të lartpërmendur, ka hasur në një person të arrestuar në Gjilan dhe në dy të arrestuar në Viti, të cilët janë intervistuar nga ekipi i MKPT-së. Gjatë intervistimit nuk ka pranuar pohime për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët policorë gjatë kohës së arrestimit.

## Kushtet fizike në këto stacione policore

19. MKPT-ja konsideron se sado e shkurtë që mund të jetë periudha e qëndrimit në ndalim policor, megjithatë kushtet në qeli duhet t'i plotësojnë disa kërkesa themelore. MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar më 13 prill 1992 në Strasburg, ka përcaktuar standardin lidhur me kushtet në qelitë ku mbahen të arrestuarit, i cili përcakton se: *“Të gjitha qelitë në stacione policore duhet të jenë të madhësisë së arsyeshme për numrin e personave të akomoduar, duhet të kenë ndriçim adekuat (shembull, dritë e mjaftueshme për të lexuar, me përjashtim të periudhave të fjetjes) dhe ventilim dhe të jenë të pajisura me karrige të fiksuar ose tavolinë). Për më shumë, personat të cilët qëndrojnë në ndalim gjatë natës duhet t'u sigurohen çarçafë dhe batanije të pastra”*.<sup>6</sup>

20. **Stacioni Policor në Shtime** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Ferizajt. MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e punës në këtë stacion janë mjaft të këqija, ka vetëm një zyre për intervistim, e cila gjendet jashtë objektit të policisë në të cilën kryhen intervistat, mbahen dosjet e të arrestuarve dhe ku i arrestuari mbahet deri në 6 orë. Stacioni Policor i Shtimes nuk ka qendër të mbajtjes, personat e arrestuar dërgohen në Qendrën e Mbajtjes në Ferizaj.

21. Sa i përket kamerave të sigurisë në këtë stacion, ka vetëm në hyrje, ndërsa objekti është pa kamera të sigurisë. Po ashtu, MKPT-ja u njoftua se është ndërtuar një objekt për Stacionin e Policisë në Shtime, që pritet të funksionalizohet në dhjetor të këtij viti ose në janar të vitit të ardhëm. MKPT-ja do të kërkojë informata të përditësuara lidhur me këtë njoftim.

22. **Stacioni Policor në Ferizaj** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Ferizajt. Kushtet fizike dhe të akomodimit ishin në gjendje jo të mirë, qelitë nuk kishin dritë natyrale të mjaftueshme, ndërsa drita artificiale ishte e dobët.

23. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se ndërtesa mban lagështi dhe erë myku, higjiena nuk ishte në nivelin e duhur. Në qelitë ku mbahen personat e arrestuar ka mungesë të çarçafëve, jastëkëve dhe mjeteve higjienike. Ndërkaq për dhomën e intervistimit të të miturve, MKPT-ja ka vërejtur se është dhomë komode dhe e këndshme; ka vërejtur se stacioni në fjalë nuk kishte tualet për stafin policor, gjë që e vështirëson kryerjen e detyrës së zyrtarit policor. MKPT-ja konsideron se stacioni në fjalë ka nevojë për renovime në hapësirat ku mbahen të arrestuarit dhe në hapësirat ku punojnë zyrtarët policorë.

<sup>6</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm, paragrafi 42. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/1680696a3f>, (05.11.2018).



24. **Stacioni Policor në Graçanicë** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Prishtinës. Në lidhje me kushtet fizike në këtë stacion, MKPT-ja ka vërejtur se ato janë të mira. Në kuadër të Stacionit Policor funksionon një zyrë për intervistim, në të cilën personat e arrestuar mbahen deri në 6 orë.
25. Stacioni Policor i Graçanicës nuk ka qendër të mbajtjes, ndërsa personat e arrestuar dërgohen në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë. Kurse në këtë stacion janë dy qeli jofunksionale.
26. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) e ka vizituar Stacioni Policor në Graçanicë në vitin 2015<sup>7</sup> dhe ka konstatuar përmirësime të dukshme në lidhje kushtet e akomodimit dhe, pjesa më e madhe e mangësive të vërejtura gjatë vizitave të mëparshme, ishte korrigjuar.
27. **Stacioni Policor në Gjilan** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Gjilani. MKPT-ja ka vërejtur se ky stacion në përgjithësi i plotëson standardet minimale për akomodim të personave të arrestuar. Qelitë ku mbahen të arrestuarit ofrojnë kushte të mira të akomodimit, përfshirë dritën natyrale, pastërtinë dhe ventilimin. Gjithashtu, madhësia e qelive është në pajtim me standardet e KPT-së<sup>8</sup>.
28. MKPT-ja ka vërejtur se dhoma për intervistimin e të miturve ishte dhomë mjaft komode dhe e këndshme. Ky stacion kishte një dhomë të veçantë për intervistimin e personave që janë viktime të dhunës në familje.
29. Sa i përket dhomave të intervistimit, KPT-ja në standardet e përcaktuara për trajtim të duhur të personave të arrestuar, thekson se gjatë vizitave në shtete të caktuara ka hasur në dhoma intervistimi të natyrës shumë frikësuese, të ngjyrosura plotësisht me ngjyrë të zezë etj. Më tej, KPT-ja thekson se në shërbime policore nuk kanë vend dhomat e tilla të intervistimit.<sup>9</sup>
30. **Stacioni Policor në Ranillug** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Gjilanit. Kushtet fizike dhe të akomodimit në këtë stacion janë shumë të mira dhe tejkalojnë standardet minimale. Qelitë ku mbaheshin personat e arrestuara kanë dritë natyrale dhe artificiale të mjaftueshme, kushtet higjienike janë të mira dhe në pajtim me standardet e KPT-së. Mirëpo, zyrtaret policorë u ankuan se kanë probleme me ujësjellësin, për shkak se ka ndërprerje të mëdha të ujit dhe probleme me ngrohjen.
31. **Stacioni Policor në Viti** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Gjilanit. MKPT-ja ka vërejtur se hapësirat ku mbahen personat e arrestuar gjatë periudhës 48 orësh janë në gjendje shumë të mirë. Qelitë ku mbahen të arrestuarit ofrojnë kushte të mira të akomodimit, përfshirë dritën natyrale, pastërtinë dhe ventilimin. Po, ashtu madhësia e qelive është në pajtim me standardet e KPT-së<sup>10</sup>.
32. **Stacioni Policor në Kaçanik** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Ferizajt. MKPT-ja ka vërejtur se Qendra e Mbajtjes në Kaçanik nuk është funksionale në

<sup>7</sup> Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

<sup>8</sup> Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

<sup>9</sup> Për më shumë, shih në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed>, paragrafi 37.

<sup>10</sup> Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

5 vitet e fundit. Kjo qendër eshtë mbyllur për shkak se nuk i plotëson kushtet higjienike. Kurse të arrestuarit mbahen në zyrën e intervistave deri në 6 orë. Në rastet kur urdhërohet dërgimi në mbajtje, të arrestuarit dërgohen në Qendrën e Mbajtjes në Ferizaj. MKPT-ja u njoftua se në Stacionin Policor në Kaçanik pritet të rinovohen hapësirat ku mbahen të arrestuarit dhe hapësirat ku punojnë zyrtarët policorë. MKPT-ja do të kërkojë informata të përditësuara lidhur me këtë njoftim.

33. **Stacioni Policor në Shtërpçë** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Gjilanit. Ky stacion policor nuk posedon qeli të mbajtjes për personat e arrestuar. Të arrestuarit mbahen në zyrën e intervistave deri në 6 orë, ndërsa për mbajtje të mëtejme sipas urdhrit të prokurorit, të arrestuarit dërgohen në Qendrën e Mbajtjes në Gjilan.
34. Megjithatë është shqetësues fakti se gjatë vizitës së ekipit të MKPT-së në këtë stacion, në një dhomë intervistimi ka gjetur tri objekte të forta, të cilat, sipas zyrtarëve policorë, ishin objekte të konfiskuara nga personat e arrestuar në vend të ngjarjes dhe mbahen aty si dëshmi.<sup>11</sup> MKPT-ja u ka rekomanduar zyrtarëve policorë se objektet e tilla duhet të hiqen menjëherë nga zyra ku intervistohen të arrestuarit.
35. MKPT-ja gjatë vizitave në Stacionin Policor në Kaçanik dhe në atë të Kamenicë, ka vërejtur se në dhomat e intervistimeve gjendeshin nga një shkop druri, por të cilët ishin të shënjuar me numrin e rastit. Sipas zyrtarëve policorë, këto mjete janë konfiskuar nga të arrestuarit dhe mbahen aty si dëshmi për rastet.
36. Për më shumë, MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportin për vizitën në Spanjë, i publikuar në vitin 2011, thekson se delegacioni ka gjetur shkopinj dhe shkopinj bejsbolli në disa stacione policore të caktuara, në dhoma të intervistimit, të cilët nuk ishin të shënjuara. KPT-ja më tej thotë në raport se një situatë e tillë, përveçse nxit spekulimet për sjellje jo të duhur të policisë, gjërat e tilla janë burim potencial i rrezikut për zyrtarët policorë, por edhe për vetë të dyshuarit, për kryerje të veprave penale.
37. Mjetet e tilla apo prona e konfiskuar gjatë hetimeve penale duhet të regjistrohet në një regjistër të veçantë, të shënjohe në mënyrën e duhur (që identifikon edhe rastin të cilit i referohet) dhe të ruhen në vendin e dedikuar për ruajtje të mjeteve të tilla. Përmes raportit në fjalë, KPT-ja u rekomandoi autoriteteve spanjolle që të gjitha mjetet e tilla të paautorizuara të largohen nga hapësirat ku personat mund të mbahen apo të merren në pyetje.<sup>12</sup>
38. **Stacioni Policor në Novobërdë** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Gjilanit. MKPT-ja ka vërejtur se objekti i këtij stacioni është i rinovuar. Sipas zyrtarëve policorë, dhoma ku mbahen dëshmitë është dëmtuar rëndë. Ky stacion nuk ka qendër të mbajtjes, personat e arrestuar sipas urdhrit të prokurorit dërgohen në mbajtje të mëtejme në Qendrën e Mbajtjes në Gjilan. Ndërsa personat e arrestuar intervistohen në këtë stacion në zyrën e intervistës dhe mbahen deri në 6 orë.

<sup>11</sup> Objektet e gjetura mund të përshkruhen si në vijim: tre shkopinj, dy nga këta shkopinj duket se janë kablllo elektrike të mbështjella me shirit izolues fund e krye dhe një shkop tjetër më i gjatë i mbështjellë vetëm në fillim për aq sa mund të kapet me dorë.

<sup>12</sup> Raporti i KPT për vizitën në Spanjë, publikuar në vitin 2011, paragrafi 34, në: <https://rm.coe.int/16806cb01c>.



39. **Stacioni Policor në Kamenicë** funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Gjilanit. Qendra e mbajtjes në këtë stacion nuk është funksionale prej katër vitesh. Të arrestuarit dërgohen në Qendrën e Mbajtjes në Gjilan ose në Viti, apo në ndonjë qendër tjetër të mbajtjes. Përndryshe, të arrestuarit intervistohen dhe mbahen deri në 6 orë në zyrën e intervistimit brenda stacionit policor.
40. Në të gjitha stacionet e vizituara, MKPT-ja ka vërejtur se të arrestuarit nuk furnizohen me mjete personale higjienike. MKPT-ja konsideron se autoritetet relevante duhet të ndërmarrin hapa konkret për të pajisur qendrat e mbajtjes me mjete higjienike.
41. Po ashtu, në të gjitha stacionet që i ka vizituar, MKPT-ja ka vërejtur se tualetet ndahen nga pjesa tjetër e qelisë me një mur i cili është joadekuat (është i ulët) për të garantuar respektimin e privatësisë së të ndaluarve. MKPT-ja konsideron se autoritetet përgjegjëse duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të garantuar privatësinë e të ndaluarve.

### **Sistemi i thirrjes**

42. Asnjëri nga stacionet e vizituara nuk posedon sistem të thirrjes. MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportet për Kosovën për vizitën në vitin 2015, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente në Kosovë që qelitë në stacionet policore të pajisen me sistem të thirrjes, gjë që të arrestuarve do t'u mundësonte kontakt më të lehtë me zyrtarët policorë në rast nevojë.<sup>13</sup>

### **Regjimi**

43. Në raportin e 12-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 2002, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës thekson se personave të cilët mbahen në arrest në polici më shumë se 24 orë, duhet që brenda mundësive t'u ofrohet ajrosje ditore.<sup>14</sup> MKPT-ja u njoftua nga zyrtarët policorë në stacionet e vizituara se të arrestuarve nuk u ofrohet ajrosja as kur qëndrojnë aty edhe më shumë se 24 orë, pasi që nuk kanë kushte fizike.
44. Neni 170, paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton: *“Brenda njëzet e katër (24) orëve, personi i arrestuar ka të drejtë në së paku tetë (8) orë pushim pa ndërprerje dhe gjatë kësaj kohe nuk merret në pyetje e as nuk trazohet nga policia lidhur me hetimin”.*
45. Në stacionin policor në Viti, MKPT-ja u njoftua se të arrestuarve u ofrohet një ajrosje e shkurtër në oborrin e këtij stacioni nën përcjelljen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve policorë. Por stacioni nuk ka ndonjë hapësirë të destinuar pikërisht për këtë çështje. MKPT-ja konsideron se në pajtim me rekomandimin e KPT-së, autoritetet kompetente, sa herë që kjo të jetë e mundur, duhet t'u sigurojnë të ndaluarve ajrosje jashtë qelisë edhe në stacionet tjera policore ku të arrestuarit mbahen më gjatë se 24 orë.

### **Kujdesi shëndetësor**

46. Shërbimet mjekësore janë e drejtë themelore e personave të cilët arrestohen nga policia. MKPT-ja u njoftua se shërbimet mjekësore të të arrestuarve, në të gjitha stacionet e

<sup>13</sup> Raporti i KPT për vizitën në Kosovë në vitin 2015, përgjigja e autoriteteve. Shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo> (05.11.2018).

<sup>14</sup> Raporti i 12-të i Përgjithshëm i KPT, paragrafi 47, në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (05.11.2018).



vizituara, u jepen në qendrat më të afërta të mjekësisë familjare dhe në institucione të tjera publike sipas nevojës. MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj të arrestuarve mbahen në dosjen e tij/saj personale.

## **Ushqimi**

47. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton obligimin që, nëse personi i privuar nga lirie mbahet më shumë se 12 orë, duhet t'i sigurohen tri racione ushqim në ditë.<sup>15</sup> Personave të arrestuar, të cilët dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqim brenda 24 orëve sipas kontratës që ka Policia me kompaninë kontraktuese. Në rastin e Stacionit Policor në Ferizaj, ushqimi për personat në mbajtje sigurohet nga kazerma e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ndërsa në stacionet tjera policore të vizituara ushqimi sigurohet drejtpërdrejt nga kompania kontraktuese.

## **Parashtrimi i ankesave nga personat e arrestuar**

48. Lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, të arrestuarit kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë në stacionin policor ku mbahet dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. Përveç kësaj, të arrestuarit mund t'i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'u mundësuar të arrestuarve parashtrimin e ankesës në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka instaluar kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtje të të arrestuarve. Këto kuti të ankesave mund të hapen vetëm nga personeli i caktuar i Avokatit të Popullit.

49. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se Inspektorati Policor i Kosovës ka vendosur një kuti të ankesave në hyrje të Stacionit Policor në Kaçanik. MKPT-ja konsideron se kjo është një praktikë e mirë, e cila u ofron qytetarëve që drejtpërdrejt t'i drejtohen organit kompetent me ankesë lidhur me trajtimin që u bëhet nga zyrtarët policorë.

50. MKPT-ja gjatë vizitës në Stacionin Policor në Kamenicë, ka vërejtur se stacioni posedon një libër (regjistër) me të dhëna gjithëpërfshirëse të ankesave të qytetarëve, në të cilin regjistrohen të gjitha ankesat e qytetarëve, të cilat më pas procedohen tek organet kompetente brenda Policisë së Kosovës ose Inspektoratit Policor të Kosovës. MKPT-ja konsideron se kjo është një praktikë shumë e mirë dhe në pajtim me kërkesat e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

---

<sup>15</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 170 paragrafi 3.

Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës, MKPT-ja i rekomandon Policisë së Kosovës:

- Të bëhen renovimet e nevojshëm në Qendrën e Mbajtjes në Stacionin Policor në Ferizaj.
- Në të gjitha qendrat e mbajtjes të stacioneve policore të vizituara, tualetet e qelive ku mbahen të ndaluarit, duhet të pajisen me një ndarje e cila respekton privatësinë.
- Të largohen mjetet e forta nga zyrat ku intervistohen apo mbahen personat e arrestuar ose ndaluar, në të gjitha stacionet policore, të cilat pretendohet se janë mjete të konfiskuara në cilësi të dëshmisë.
- Të informohet MKPT-ja për datën e funksionalizimit të Stacionit Policor në Shtime.
- Të furnizohen të ndaluarit me mjete personale higjienike.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit